

Përballja me dhunën ndërgrupore

*Shpend Voca**

*Mimoza Kamberi***

Abstrakt

Në konfliktet ndërgrupore, ballafaqimi me të kaluarën është esencial për pajtim. Tendencat e njerëzve për të fajësuar njëri-tjetrin për vuajtjet e kaluara të brendagrupit nga jashtëgrupit mund të shkaktojë sfida të konsiderueshme për pajtim. Përndryshe, marrëdhëniet ndërgrupore mund të përmirësohen nëse njerëzit shfaqin qëndrime për të falur jashtëgrupin për vuajtjet e shkaktuara grupit të brendshëm. Ky studim ka analizuar se si anëtarët e grupeve rivale reagojnë kur diskutojnë rreth dhunës ndërgrupore të përjetuar. Ky studim është bazuar në takimet me dialog të strukturuar me pjesëmarrës shqiptarë dhe serbë në Kosovë. Duke përdorur udhëzuesin e Braun dhe Clarke për analizë të të dhënave, rezultatet kanë treguar se anëtarët e grupit rival përqendrohen kryesisht në ngjarjet kur brendagrupi ka vuajtur përderisa neglizhojnë ngjarjet kur jashtëgrupi ka vuajtur. Studimi ka gjetur se njerëzit përdorin strategji të ndryshme për të mohuar apo justifikuar dhunën e brendagrupit ndaj jashtëgrupit. Kërkim falja, shfajësimi, fajësimi i të tjerëve, përgjegjësia kolektive dhe turpi i brendagrupit janë temat e shfaqura kur grupet rivale kanë diskutuar për dhunën ndërgrupore në të kaluarën.

Fjalë kyç: *ballafaqimi me të kaluarën, kërkimfalja, shfajësimi, turpi brendagrupor*

* *Shpend Voca, PhD cand, Kolegji AAB, Departamenti i Psikologjisë, shpend.voca@aab-edu.net*

** *Mimoza Kamberi, PhD cand, Kolegji AAB, Departamenti i Psikologjisë, mimoza.kamberi@aab-edu.net*

Hyrje

Në Kosovë, gjatë periudhës 1998 dhe 1999, forcat serbe vranë së paku 10.000 shqiptarë të Kosovës dhe me forcë dëbuan nga shtëpitë e tyre më shumë se 800.000 shqiptarë të Kosovës¹. Për të ndaluar dhunën e ushtruar ndaj shqiptarëve, Aleanca e Traktatit Verior të Atlantikut (NATO) filloi fushatën e sulmeve ajrore kundër grupeve të armatosura serbe në periudhën mars – qershor 1999. Konflikti i dhunshëm në mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë përfundoi në qershor 1999. Menjëherë pas konfliktit, komuniteti serb në Kosovë ishte cak i vrasjeve, kërcënimeve të përsëritura dhe formave të ndryshme abuzuese. Si rezultat i dhunës, rreth 200.000 serbë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre².

Në shoqëritë e pas-konfliktit, të cilat kanë përjetuar vuajtje të ndërsjellta, grupet rivale mbajnë interpretime të ndryshme rreth dhunës ndërgrupore në të kaluarën³. Të dyja grupet në konflikt kanë tendencë të justifikojnë ushtrimin e dhunës ndaj jashtëgrupit duke paraqitur dhunën si një reagim vetë-mbrojtës nga dëmtimi i jashtëgrupit. Kjo bëhet duke minimizuar pasojat e dhunës së brendagrupit ushtruar ndaj jashtëgrupit dhe maksimizuar pasojat e dhunës së jashtëgrupit ushtruar ndaj brendagrupit⁴. Si rrjedhojë, të dyja grupet refuzojnë mundësinë

¹ Tim Judah, *What Everyone Needs to Know*. (Canada: Oxford University Press, 2008).

² Internally Displaced Monitoring Centre, *IDPs still seeking housing solutions and documentation to access their rights*. (Geneva: Norwegian Refugee Council, 2009), 295.

³ Masi Noor, Rupert Brown and Garry Prentice. "Precursors and mediators of intergroup reconciliation in Northern Ireland: A new model." *British Journal of Social Psychology* 47, (2008): 481-495.

⁴ Johanna R. Vollhardt. "Collective victimization," In *The Oxford handbook of intergroup conflict* ed. Linda R. Tropp, 136-157 (New York: Oxford University Press, 2012).

e pranimi të dhunës së brendagrupit ushtruar ndaj jashtëgrupit, e cila pengon pajtimin ndërgrupor⁵.

Nga perspektiva e identitetit social mund të kuptojmë pse grupet tentojnë të minimizojnë ose mohojnë pasojat e dhunës së brendagrupit ndaj jashtëgrupit⁶. Sipas perspektivës së identitetit social, individët janë të motivuar të mbajnë një vlerësim pozitiv të grupit të tyre⁷. Pranimi i dhunës së brendagrupit ndaj jashtëgrupit mund të zvogëlojë vlerësimin pozitiv të grupit, sikurse të kërcënojë imazhin moral të grupit, prandaj individët përdorin strategji të ndryshme si justifikimi ose mohimi i dhunës së ushtruar nga brendagrupi në mënyrë që të zvogëlojnë kërcënimet e imazhit moral të grupit⁸.

Në këtë studim, qëllimi jonë është të hulumtojmë reagimet e anëtarëve të grupeve rivale kur diskutojnë dhunën e ushtruar ndaj grupit të jashtëm. E para, çfarë janë temat kur diskutojnë dhunën ndërgrupore në të kaluarën? E dyta, çfarë janë reagimet e njerëzve kur diskutojnë rreth dhunës ndërgrupore në të kaluarën? Për të hulumtuar këto çështje, ne kemi analizuar përmbajtjen e tri takimeve të dialogut të strukturuar ndërmjet pjesëmarrësve shqiptarë dhe serbë nga Kosova.

⁵ Sabina Cehajic and Rupert Brown. "Silencing the past: Effects of intergroup contact on acknowledgment of ingroup responsibility." *Social Psychological and Personality Science* 1, no. 2, (2010): 190-196.

⁶ Noor, Brown and Prentice, Precursors and mediators of intergroup reconciliation in Northern Ireland: A new model (see footnote 3).

⁷ Henry Tajfel and Jonathan Turner. "An integrative theory of social conflict," In *The Social Psychology of Intergroup Relations* eds. William G. Austin, Stephen Worchel (Brooks/Cole: Monterey, 1979). 33-47

⁸ Sabina Cehajic, Rupert Brown and Emanuele Castano. "Forgive and forget? Antecedents and consequences of intergroup forgiveness in Bosnia and Herzegovina." *Political Psychology* 29, (2008): 351-367.

Ballafaqimi me dhunën ndërgrupore

Ballafaqimi me dhunën ndërgrupore është një element esencial i marrëdhënieve ndërgrupore⁹. Marrëdhëniet ndërgrupore nuk kanë gjasa të përmirësohen nëse grupet tentojnë të mohojnë ose justifikojnë dhunën e anëtarëve të brendagrupit ndaj jashtëgrupit¹⁰. Në të kundërtën, pranimi i dhunës së brendagrupit ndaj jashtëgrupit mund të lehtësojë marrëdhëniet ndërgrupore për disa arsye¹¹. E para, grupet, të cilat kanë vuajtur si rezultat i dhunës prej një grupi tjetër kanë nevojë për njohje të vuajtjes së tyre¹². E dyta, pranimi i dhunës së brendagrupit ndaj jashtëgrupit përbën një kusht të domosdoshëm për përvoja të tjera psikologjike, të cilat mund të përmirësojnë marrëdhëniet ndërgrupore¹³. Për shembull, pranimi i dhunës së brendagrupit ndaj jashtëgrupit nxit empati ndaj jashtëgrupit dhe rrit perceptimin e përgjegjësisë brendagrupore¹⁴. Pranimi i dhunës së brendagrupit ndaj jashtëgrupit mund të hapë rrugën për

⁹ Ibid.

¹⁰ Noor, Brown and Prentice, Precursors and mediators of intergroup reconciliation in Northern Ireland: A new model (see footnote 3).

¹¹ Sabina Cehajic, Rupert Brown and Roberto Gonzalez. "What do I care? Perceived ingroup responsibility and dehumanization as predictors of empathy felt for the victim group." *Group processes and Intergroup Relations*, 12(6), (2009): 715-729.

¹² Nurit Shnabel et al. "Promoting reconciliation through satisfaction of the emotional needs of victimized and perpetrating group members: the needs based model of reconciliation." *Personality and Social Psychology Bulletin* 35(8), (2009): 1021-1030.

¹³ Sabina Cehajic, Rupert Brown and Roberto Gonzalez. "What do I care? Perceived ingroup responsibility and dehumanization as predictors of empathy felt for the victim group." *Group processes and Intergroup Relations*, 12(6), (2009): 715-729.

¹⁴ Ibid.

ciklinkërkim-falje-shfajësim, e cila është e rëndësishme për pajtimin ndërgrupor¹⁵.

Studimet e kaluara kanë treguar pasojat pozitive të pranimit së brendagrupit ndaj jashtëgrupit¹⁶. Por, pak është bërë në atë se çka ndodh në të vërtetë kur anëtarët e grupeve rivale takohen dhe diskutojnë rreth dhunës ndërgrupore në të kaluarën. Në këtë studim, ne kemi eksploruar se si njerëzit reagojnë kur anëtarët e grupeve rivale takohen dhe diskutojnë rreth dhunës ndërgrupore.

Takimet e strukturuar të dialogut ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve

Ky studim është bazuar në takime të strukturuar të dialogut ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, që janë mbajtur gjatë periudhës 2006 dhe 2008. Për këtë studim ne kemi analizuar tre takime të strukturuar të dialogut. Takimet e strukturuar të dialogut ishin organizuar si pjesë e projektit me qëllim të lehtësimit të kthimit të serbëve të zhvendosur nga pronat e tyre. Pjesëmarrësit shqiptarë dhe serbë në takime për dialog kanë qenë fqinjë para përfundimit të konfliktit në 1999. Në këtë projekt përgjegjësitë tona ishin të koordinojmë, mbikqyrim dhe raportojmë për aktivitetet e projektit.

Çdo takim i dialogut ka zgjatur dy ditë e gjysmë. Takimet e dialogut përbëheshin nga dhjetë seanca me intervenim të vogël nga lehtësuesi. Në çdo takim ishin përafërsisht 15-20 pjesëmarrës me numër të barabartë të pjesëmarrësve shqiptarë dhe serbë.

¹⁵ Shnabel et al., Promoting reconciliation through satisfaction of the emotional needs of victimized and perpetrating group members: the needs based model of reconciliation (see footnote 12).

¹⁶ Cehajic and Brown, Not in my name: A social psychological study of antecedents and consequences of acknowledgment of ingroup atrocities (see footnote 11).

Takimet ishin të lehtësuara nga lehtësuesi ndërkombëtar me një përvojë të gjerë në regjionin e Ballkanit. Në përgjithësi, pjesëmarrësit në takime dialogu punonin në grupe të vogla të përziera (shqiptarë dhe serbë) dhe diskutonin se si konflikti ka ndikuar në jetën e tyre. Pastaj, ata gjithashtu diskutonin gjatë seancave plenare të përbëra nga të gjithë pjesëmarrësit.

Analizimi i të dhënave

Gjatë sesioneve plenare ne kemi marrë shënime në formë të shkruar. Të gjitha shënimet ishin të përkthyer në gjuhë angleze. Kjo analizë është e bazuar në transkriptim të plotë nga tri takimet e dialogut ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë. Analiza e të dhënave është bazuar në udhëzuesin për analizimin e të dhënave nga Braun dhe Clarke (2006)¹⁷. Së pari, ne kemi koduar të dhënat duke përdorur qasjen e udhëhequr nga teoria. Kjo qasje na lejoi që të fokusohemi në përmbajtjen specifike lidhur me pyetjet kërkimore të parashtruara për këtë studim (Howitt, 2010)¹⁸. Së dyti, të dhënat e koduara ishin të kategorizuara në grupe të veçanta. Kategorizimi i të dhënave në grupe të veçanta na lejoi që t'i identifikojmë temat. Çdo temë ishte vendosur në formë tabelare në letër. Së treti, të dhënat dhe temat vazhdimisht janë shqyrtuar.

Sipas Braun dhe Clarke (2006) analiza tematike është një metodë e identifikimit, analizimit dhe raportimit të temave brenda të dhënave. Tema duhet të rrjedhë nga të dhënat, varësisht nga pyetjet kërkimore. Për këtë analizë, ne kemi identifikuar dhe analizuar të dhënat në raport me përqendrimin

¹⁷ Braun Virginia and Clarke Virginia. "Using thematic analysis in psychology." *Qualitative Research in Psychology* 3(2), (2010): 77-101.

¹⁸ Denis Howitt, *Introduction to Qualitative Research Methods in Psychology*. (London, United Kingdom: Pearson, 2010).

dhe reagimet e grupeve rivale, kur kanë qenë duke biseduar për dhunën ndërgrupore. Seksioni vijues përshkruan rezultatet e hulumtimit të bazuara në komentet e pjesëmarrësve.

Rezultatet

Çfarë është përqendrimi i njerëzve kur diskutojnë për dhunën ndërgrupore të së kaluarës?

Kur diskutohet dhuna ndërgrupore, pjesëmarrësit shqiptarë dhe serbë kanë tendencë të theksojnë kryesisht ngjarjet në periudha të caktuara kohore, vetëm kur grupi i tyre ka vuajtur si rezultat i dhunës nga jashtëgrupi. Pjesëmarrësit shqiptarë përqendrohen në dhunën e kryer nga serbët ndaj shqiptarëve kryesisht gjatë 1998 dhe 1999, ndërsa pjesëmarrësit serbë fokusohen në dhunën e kryer nga shqiptarët pas periudhës 1999. Gjatë diskutimit të periudhës së 1999-ës, pjesëmarrësi shqiptar theksoi:

Meqenëse kam pasur rastin të kthehem menjëherë pas luftës dhe të shoh se si ka qenë situata në fshat, personi i parë që kam takuar në shtëpinë e tij ka qenë z. xxx dhe kur u ktheva unë pashë një terror të vërtetë dhe natyrisht që atij ju kujtohet se kur e ka pyetur atë rreth shtëpisë dhe ai ishte përgjigj se shtëpia juaj është djegur para tri dite (Albani, shqiptar, mashkull)¹⁹.

Dhe fokusimi i pjesëmarrësit serb pas periudhës 1999

Realiteti është se serbët jetojnë në qendra kolektive në kushte shumë të vështira, pas 9 viteve ata nuk kanë qenë në gjendje të kthehen në pronat e tyre dhe nuk kanë qenë të integruar në vendet e tyre ku jetojnë. Ata jetojnë në kushte shumë të rënda; ky është realiteti se pronat e uzurpuara serbe ende nuk janë kthyer. Këto janë gjëra që u duhet kushtuar vëmendje, pavarësisht se cila është

¹⁹ Emrat e përmendur këtu janë pseudonime.

situatë ekonomike, ne duam të kthehemi në pronat tona (Zoran, serbe, femër)

Çfarë janë reagimet e njerëzve kur diskutojnë dhunën ndërgrupore?

Kur diskutojnë rreth dhunës ndërgrupore përgjigjet e pjesëmarrësve janë vendosur në shtatë kategori: shmangia, justifikimi, kërkimfalja, shfajësimi, fajësimi i të tjerëve, përgjegjësia kolektive dhe turpi brendagrupor.

Shmangia. Një nga reagimet më të zakonshme të pjesëmarrësve lidhur me dhunën ndërgrupore është të harruarit e dhunës ndërgrupore dhe perspektiva drejt së ardhmes. Kjo formë e reagimit ishte vërejtur tek pjesëmarrësit shqiptarë dhe serbë. Për shembull, një pjesëmarrës kishte theksuar:

Prandaj unë pajtohem që të kaluarën t'ua lëmë historisë dhe ne duhet të provojmë në mënyrë konstruktive të zgjedhim çështjet tona (Aleksandër, serb, mashkull)

Në të njëjtën mënyrë, një pjesëmarrës tjetër theksoi:

Unë jam i sigurt se nëse kthehemi në të kaluarën ne nuk mund të ecim përpara, ne duhet të shikojmë drejt të ardhmes, tash Kosova është në një realitet të ri, ka shpallur pavarësinë dhe bashkë-qytetarët kush dëshiron të kthehet duhet të pranojë këtë realitet dhe të adaptohet në të. (Blin, Shqiptar, mashkull)

Justifikimi. Nëse biseda rreth dhunës ndërgrupore nuk shmanget, pjesëmarrësit shqiptarë dhe serbë, siç përshkruam më lart, theksonin kryesisht përvojat e vuajtjeve të brendagrupit si rezultat i dhunës jashtëgrupore, përderisa nënvlerësonin përvojat e vuajtjeve të jashtëgrupit si rezultat i dhunës së brendagrupit. Pjesëmarrësit shqiptarë dhe serbë nënvlerësonin përvojat e vuajtjeve të jashtëgrupit duke përdorur strategji të ndryshme për të justifikuar dhunën brendagrupore.

Për shembull, pjesëmarrësit shqiptarë reagonin duke minimizuar pasojat e dhunës së brendagrupit ndaj jashtëgrupit përderisa maksimizonin pasojat e dhunës së jashtëgrupit ndaj brendagrupit. Për shembull, një pjesëmarrës u përgjigj:

Është e vërtetë se shtëpitë tona janë djegur, por ka një dallim në mes djegieve të shtëpive të shqiptarëve dhe serbëve, ne nuk mund ti barazojmë njëjtë, përderisa shtëpitë e shqiptarëve ishin djegur sistematikisht në mënyrë të organizuar nga shteti serb, në mënyrë që ne kurrë mos të kthehemi në shtëpitë tona, ndërsa shtëpitë e serbëve ishin djegur si rezultat i frustracionit të shqiptarëve, e cila nuk është mirë. Për këtë arsye në këtë kontekst unë dua të them se nuk mund ta pranoj si të njëjtë djegien e shtëpive të shqiptarëve dhe serbëve (Albani, shqiptar, mashkull)

Pjesëmarrësit shqiptarë gjithashtu përdorrsn diskursin e viktimizimit. Në këtë aspekt, pjesëmarrësit shqiptarë nuk i minimizonin pasojat e dhunës brendagrupore ndaj serbëve, por legjitimonin dhunën brendagrupore, siç paraqitet në këtë shembull:

Nuk është e njëjtë si viktimë si kriminel. Ta marrim fshatin tim, Mr.xxx e dinë që ne kemi 18 bashkë-fshatarë, të cilët kanë qenë të vrarë gjatë luftës, 16 anëtarë i takojnë një familjeje përderisa komunitetit serb vetëm shtëpitë i janë djegur, ne jemi duke ja ndërtuar shtëpitë tani dhe të kthehen të gëzuar, por njerëzit e vdekur nuk mund të kthehen prapa. Janë 165 viktima të luftës prej komunës tonë (Blini, shqiptar, mashkull)

Kur justifikonin dhunën brendagrupore ndaj shqiptarëve, pjesëmarrësit serbë reagonin duke u fokusuar në dhunën reciproke. Për shembull, një pjesëmarrës tha:

Është e vërtetë se gjatë 1999 ka pasur grupe të paramilitarëve. Ne kemi dëgjuar detaje prej xxx, por për t'u dhënë përgjigjen e pyetjes së xxx, se kush ishte serbi lokal që dogji shtëpitë, të njëjtën pyetje mund ta bëj unë, të pyes se kush dogji shtëpitë e serbëve gjatë 1999. Të gjithë ne e dimë se varrezat ortodokse në Miradinë e Epërme janë shkatërruar. Nuk ka asnjë monument atje. Pra kur xxx shkon në shtëpi të tij duhet hapur të thotë rreth gjërave që i kanë ndodhur dy anëve, pse varrezat e serbëve u shkatërruan dhe kush e bëri atë, shqiptarët lokal apo dikush tjetër. Unë nuk dua të justifikoj asnjërin palë që bën gjëra të këqija. Unë besoj se forcat

e sigurisë do të bëjnë punën e tyre, për të kapur personat përgjegjës dhe për t'ju dhënë dënimin (Dragan, serb, mashkull)

Kërkim falja. Pjesëmarrësit shqiptarë në mënyrë eksplicite e theksonin se serbët duhet të kërkojnë falje për dhunën ndaj shqiptarëve. Një pjesëmarrës tha:

Unë konsideroj se ata duhet të tregojnë dashamirësi dhe në njëfarë mënyre pastrojnë veten e tyre, sepse njerëzit me të vërtetë mund të falin. Asnjëherë nuk kam dëgjuar për ndonjë qytetar të Miradisë së Epërme nga nacionaliteti serb, që ka kërkuar falje për atë që ka ndodhur (Fidani, shqiptar, mashkull)

Përderisa pjesëmarrësit shqiptarë theksonin se serbët duhet të kërkojnë falje, pjesëmarrësit serbë theksonin se edhe shqiptarët edhe serbët duhet t'i kërkojnë falje njëri-tjetrit:

Ka një urrëjtje në mes komuniteteve, si një element pozitiv mund të jetë falja e ndërsjelltë nga shqiptarët dhe serbët, sepse gjërat e këqija kanë ndodhur nga të dyja palët (Aleks, serb, mashkull)

Shfajësimi. Ngushtë lidhur me kërkim faljen, duke diskutuar pritshmëritë e shqiptarëve dhe serbëve ndaj njëri tjetrit, një pjesëmarrës në emër të grupit të shqiptarëve tha:

Ne do të dëshironim që serbët të kërkojnë falje për mizoritë dhe krimet e bëra gjatë luftës në emër të tyre (Ditmir, shqiptar, mashkull) Fajësimi i të tjerëve.

Një reagim i zakonshëm në mesin e pjesëmarrësve ishte fajësimi i grupit tjetër për dhunën e brendagrupit ndaj jashtëgrupit. Për shembull, një pjesëmarrës tha:

Nga biseda me ish-komshinjtë, kam përshtypjen se ata po shikojnë që të fajësojnë dikë, por nëse vazhdojmë në këtë mënyrë ne do të shkojmë në luftën e dytë botërore, e cila natyrisht që nuk do të na i zgjidhë problemet tona aktuale (Petar, serb, mashkull)

Gjatë diskutimit, gjithashtu u vërejt se fajësimi është shprehur në formë të parashtrimit të pyetjes, si për shembull:

Por pse gjatë konfliktit shtëpitë e shqiptarëve ishin djegur përderisa të serbëve asnjë. Dhe kështu është një fshehtësi e madhe, që ende askush nuk e di se kush i ka djegur, por në bazë të informatave që kam marrë nga serbët lokal më kanë treguar se shtëpitë ishin djegur prej serbëve lokal (Albani, shqiptar, mashkull)

Në mënyrë të ngjashme, një pjesëmarrës tjetër përgjigjet duke fajësuar në formë të parashtrimit të pyetjes:

Është e vërtetë se gjëra të tmerrshme kanë ndodhur, por tani jemi në kohë të paqes. Tash unë jam duke ju pyetur juve ku janë pronat tona, ku janë shtëpitë tona (Nikola, serb, mashkull) Përgjegjësia kolektive.

Disa pjesëmarrës shqiptarë gjithashtu përmendën se serbët duhet të marrin përgjegjësi kolektive për dhunën brendagrupore ndaj jashtëgrupit. Një pjesëmarrës theksoi:

Unë dua të them se ne nuk mund të ikim prej përgjegjësisë, thuajse asgjë nuk ka ndodhur, përderisa atje ka pasur grabitje sistematike. Pajisjet janë transportuar nga automjetet, traktorët tona, sepse refugjatët nga Kroacia nuk kanë pasur automjete për ti transportuar. Mos ta zgjati më shumë, çka dua të them është se ne nuk mund të bëjmë kinse asgjë nuk ka ndodhur (Albani, shqiptar, mashkull)

Në lidhje me dhunën e shqiptarëve ndaj serbëve, pjesëmarrësit u përgjigjen duke minimizuar pasojat e gjërave të gabuara, prandaj mohonin përgjegjësinë e Shqiptarëve për dhunë. Për shembull, një pjesëmarrës theksoi:

Ne jemi përjashtuar me dhunë nga fshati, të gjitha gjërat që patëm në familje, në fshatin tonë, ne shkuam me një çantë të dorës. Pajisjet tona të agrokulturës kanë qenë të grabitura, çdo gjë jo vetëm në shtëpi, bagëtitë tona, kamionët dhe çdo gjë që

kishim. Përderisa këta shokët tanë kanë ngarkuar traktorët e tyre dhe i kanë marrë me vete në Serbi (Driton, albanian, male).

Përderisa pjesëmarrësit shqiptarë theksonin përgjegjësinë e jashtëgrupit, pjesëmarrësit serbë përgjigjeshin duke theksuar gabimet e ndërsjellta. Një pjesëmarrës shtoi:

Është e vërtetë që gjëra të tmerrshme kanë ndodhur, por tash jemi në kohë paqeje. Tani unë jam duke ju pyetur ju ku janë pronat tona, ku janë shtëpitë tona. Janë bërë gabime të ndërsjella nga të dyja anët, por dëmet njerëzore janë më të këqijat (Nikola, serb, mashkull)

Turpi brendagrupor. Në një shkallë më të vogël pjesëmarrësit përmendën turpin bazuar në dhunën brendagrupore. Për shembull, një pjesëmarrës tha:

Një shembull personal, menjëherë pas luftës, në qytet ka ardhur një shqiptar i quajtur xxx. Më thanë se ai nuk dëshiron të flasë me askënd, por ndërkohë ai erdhi dhe më përshëndeti mua. Unë e pyeta atë se si është babai juaj? Ai më tregoi se ai ishte mbytur nga serbët. Unë vetëm u largova i turpëruar. Ditën tjetër ai më tha mua se ai nuk më fajëson mua për atë dhe unë i thashë që po më vjen keq pasi që grupi im etnik ka bërë atë krim (Dejan, Serb, mashkull)

Diskutim

Qëllimi i këtij studimi është i dyanshëm: e para, çfarë është fokusi i grupeve rivale kur diskutojnë dhunën ndërgrupore; e dyta, çfarë janë reagimet e njerëzve kur diskutojnë rreth dhunës së brendagrupit ndaj jashtëgrupit. Për të hulumtuar këto çështje, ne analizuam përmbajtjen e tri takimeve të dialogut të strukturuar ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës.

Gjetjet tona tregojnë se njerëzit kanë tendencë të fokusohen në dhunën e jashtëgrupit ndaj brendagrupit përderisa nënvlerësojnë dhunën e brendagrupit ndaj jashtëgrupit. Kjo nënkupton se grupet në konflikt theksojnë kryesisht periudhën kur brendagrupi ka vuajtur përderisa neglizhojnë periudhën kur jashtëgrupi ka vuajtur si rezultat i dhunës brendagrupore. Në rastin tonë, kur diskutohej dhuna ndërgrupore, shqiptarët fokusoheshin kryesisht në periudhën 1998 dhe 1999 kur grupi i tyre kishte vuajtur, derisa serbët fokusoheshin në periudhën pas 1999 kur grupi i tyre kishte vuajtur.

Kjo analizë gjithashtu tregon se njerëzit nuk janë të gatshëm të pranojnë dhunën që brendagrupi ka shkaktuar ndaj jashtëgrupit. Analizat treguan se njerëzit përdorin strategji të ndryshme në mënyrë që të mohojnë dhunën brendagrupore ndaj jashtëgrupit. Për shembull, një strategji për mohimin e dhunës brendagrupore ndaj jashtëgrupit është shmangia në formën e të harruarit të dhunës së brendagrupit ndaj jashtëgrupit dhe përqendrimi në çështje prezente. Nëse nuk përdorin shmangien, njerëzit mund të justifikojnë dhunën brendagrupore ndaj jashtëgrupit në forma të ndryshme. Për shembull, njerëzit ose minimizojnë pasojat e dhunës së brendagrupit ndaj jashtëgrupit ose legjitimojnë dhunën e brendagrupit si përgjigje në formë të vetë-mbrojtjes.

Përveç përdorimit të strategjive të ndryshme për të mohuar dhunën e brendagrupit ndaj jashtëgrupit, njerëzit gjithashtu kërkojnë nga anëtarët e jashtëgrupit të kërkojnë falje dhe të marrin përgjegjësi për dhunën brendagrupore. Hulumtimet e kaluara tregojnë se nëse njerëzit në konflikt pranojnë dhunën që anëtarët e brendagrupit kanë shkaktuar ndaj jashtëgrupit, ata mund të ndjejnë turp brendagrupor ose të theksojnë ngjarjet e

dhunës reciproke ndërgrupore²⁰. Si rrjedhojë shpresat për pajtim në mes të grupeve rriten.

Studimi ka dy kufizime kryesore. E para, studimi është bazuar në tri takime dialogu ndërmjet pjesëmarrësve shqiptarë dhe serbë . Pasi që studimi është i bazuar në tri takime dialogu, temat që rrjedhin nga të dhënat janë të kufizuara përshkak të një numri të vogël të të dhënave. Mbase analiza e një numri më të madh të takimeve të dialogut mund të mundësonin që të diskutojmë më thellësisht temat e shfaqura siç janë kërkim falja, fajësimi i jashtëgrupit, përgjegjësia kolektive, të cilat janë elemente të rëndësishme të marrëdhënieve ndërgrupore që kanë pasur histori të dhunës ndërgrupore. E dyta, analizimi tematik është analizë deskriptive e të dhënave, prandaj, ne nuk mund të bëjmë përfundime shkak-pasojë në studim. Përveç këtyre kufizimeve, studimi ofron informata të dobishme rreth asaj se çfarë ndodh kur grupet rivale diskutojnë rreth dhunës ndërgrupore.

Përfundime

Në studimin tonë ne kemi hulumtuar strategjitë e ballafaqimit me konfliktin ndërgrupor ndërmjet pjesëmarrësve shqiptarë dhe serbë. Ne gjetëm se shqiptarët dhe serbët kanë tendencë të mohojnë ose justifikojnë dhunën e brendagrupit ndaj jashtëgrupit. Kërkim falja, shfajësimi, fajësimi i tjetrit, përgjegjësia kolektive dhe turpi brendagrupor ishin temat që kanë dalë në pah kur shqiptarët dhe serbët diskutonin për dhunën ndërgrupore. Hulumtime të ardhshme janë të

²⁰ Cehajic and Brown, Not in my name: A social psychological study of antecedents and consequences of acknowledgment of in group atrocities (see footnote 11).

nevojshme për të kuptuar pasojat e këtyre temave në marrëdhëniet ndërgrupore.

Bibliografia

Braun, Virginia, and Clarke Virginia. "Using thematic analysis in psychology." *Qualitative Research in Psychology* 3(2), (2010): 77-101.

Sabina, Cehajic and Rupert Brown. "Not in my name: A social psychological study of antecedents and consequences of acknowledgment of ingroup atrocities." *Genocide Studies and Prevention*, 3(2), (2008): 195-212.

Sabina, Cehajic, and Rupert Broën. "Silencing the past: Effects of intergroup contact on acknowledgment of ingroup responsibility." *Social Psychological and Personality Science* 1, no. 2, (2010): 190-196.

Sabina, Cehajic, Rupert Broën, and Emanuele Castano. "Forgive and forget? Antecedents and consequences of intergroup forgiveness in Bosnia and Herzegovina." *Political Psychology* 29, (2008): 351-367.

Sabina, Cehajic, Rupert Broën, and Roberto Gonzalez. "What do I care? Perceived ingroup responsibility and dehumanization as predictors of empathy felt for the victim group." *Group processes and Intergroup Relations*, 12(6), (2009): 715-729

Denis Howitt, *Introduction to Qualitative Research Methods in Psychology*. London, United Kingdom: Pearson, 2010.

Internally Displaced Monitoring Centre, *IDPs still seeking housing solutions and documentation to access their rights*. Geneva: Norwegian Refugee Council, 2009. Accessed, October 28, 2017 from <http://www.internal-displacement.org>.

Tim, Judah, *What Everyone Needs to Know*. Canada: Oxford University Press, 2008.

Masi, Noor, Rupert Brown, and Garry Prentice. "Precursors and mediators of intergroup reconciliation in Northern Ireland: A new model." *British Journal of Social Psychology* 47, (2008): 481-495.

Nurit, Shnabel, Arie Nadler, Johannes Ullrich, John F. Dovidio, and Dganit Carmi. "Promoting reconciliation through satisfaction of the emotional needs of victimized and perpetrating group members: the needs based model of reconciliation." *Personality and Social Psychology Bulletin* 35(8), (2009): 1021-1030.

Henry, Tajfel and Jonathan Turner. "An integrative theory of social conflict," In *The Social Psychology of Intergroup Relations* eds. William G. Austin, Stephen Worchel. Brooks/Cole: Monterey, 1979.

Johanna, R. Vollhardt. "Collective victimization," In *The Oxford handbook of intergroup conflict* edited by Linda R. Tropp, 136-157. New York: Oxford University Press, 2012.